



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 939/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohen** programet e studimit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
 1. *Gjuhë Shqipe, BA*, 240 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik,
 2. *Gjuhë Shqipe, MA*, 60 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik,
 3. *Letërsi Shqipe, BA*, 240 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik,
 4. *Letërsi Shqipe, MA*, 240 ECTS, maksimumi 25 studentë për vit akademik,
 5. *Studime Kulturore Orientale, MA*, 60 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik,
- II. **Riakreditohen** programet e studimit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 1. *Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun, MA*, 120 ECTS, maksimumi 25 studentë për vit akademik,
 2. *Gjuhë dhe Letërsi Turke, MA*, 60 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik,
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti i Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovet nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

| <i>Nr.</i> | <i>Programi i studimit</i> | <i>Bartësit e programit</i> |
|------------|--|---|
| 1. | <i>Gjuhë Shqipe, BA, 240 ECTS,</i> Riakreditim | Bardh Rugova Kadire Binaj Shpëtim Elezi Ardita Berisha |
| 2. | <i>Gjuhë Shqipe, MA, 60 ECTS,</i> Riakreditim | Shkumbin Munishi |
| 3. | <i>Letërsi Shqipe, BA, 240 ECTS</i> Riakreditim | Rexhep Shala Ag Apolloni Anton Berishaj Marjela Progni |
| 4. | <i>Letërsi Shqipe, MA, 60 ECTS,</i> Riakreditim | Osman Gashi |
| 5. | <i>Studime Kulturore Orientale, MA, 60 ECTS</i> Riakreditim | Abdulla Rexhepi |
| 6. | <i>Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun, MA, 120 ECTS</i> Riakreditim | Arben Fetoshi Alban Zeneli Dren Gërguri |
| 7. | <i>Gjuhë dhe Letërsi Turke, MA, 60 ECTS</i> Riakreditim | Ergin Jable |

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me këtë përbërje: Vizitat janë organizuar në datat: 13.04.2022, 20.04.2022 dhe 11.05.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Gjuhë Shqipe, BA, 240 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) standarde dhe substancialisht pesë (5) standarde.
2. Për programin e studimit *Gjuhë Shqipe, MA, 60 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4) dhe substancialisht tri (3) standarde.
3. Për programin e studimit *Letërsi Shqipe, BA, 240 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) standarde dhe substancialisht pesë (5) standarde.

4. Për programin e studimit *Letërsi Shqipe, MA*, 60 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) standarde dhe substancialisht pesë (5) standarde.
5. Për programin e studimit *Studime Kulturore Orientale, MA*, 60 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht gjashtë (6) dhe substancialisht një (1) standard.
6. Për programin e studimit *Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikum, MA*, 120 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) standarde dhe pjesërisht dy (2) standarde.
7. Për programin e studimit *Gjuhë dhe Letërsi Turke, MA*, 60 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1) dhe substancialisht gjashtë (6) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Nazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

